

**Berton SULEJMANI**  
**“SINTAKSË E GJUHËS SHQIPE (përbërësit sintaksorë)”**  
**“PARAFJALËT E SHQIPES STANDARDE”**

Ideja për paraqitjen e veprave madhore të gjuhësisë shqiptare, *Sintaksa e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)* që është një trajtesë e re teorike në fushë të sintaksës së shqipes, ku të gjitha strukturat sintaksore vështrohen në sistem, në dritën e arritjeve të gjuhësisë bashkëkohore evropiane-amerikane dhe libri i tij i fundit, i cili para disa ditësh doli nga shtypi *Parafjalët e shqipes standarde* të autorit, prof. dr. Mehmet Çeliku, na lindi në ASHSH ku u zhvilluan punimet e konferencës shkencore ndërkombëtare “*Zhvillimet në shkencat e ligjërimit dhe lënda e gjuhës dhe e letërsisë në arsimin parauniversitar*” që e organizoi Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë që u mbajt në Tiranë më 12 korrik 2019. Bashkë me profesor Çelikun vendosëm që prezantimin e këtyre veprave ta bëjmë gjatë mbajtjes së Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë, si një ngjarje e rëndësishme e albanologjisë në përgjithësi e, në veçanti e këtyre trevave shqiptare.

E për realizimin e kësaj ideje tonën, një falënderim i veçantë shkon për rektorin e Universitetit të Tetovës, të nderuarin, prof. dr. Vullnet Ametin, i cili, pa rezervë, na përkrahu dhe na mbështeti. (Faleminderit rektor).

Prof. dr. Mehmet Çeliku është një ndër figurat më të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare. Është marrë me dialektologji, leksikologji, morfologji e sintaksë. Gjithnjë do të mbetet një personalitet i nderuar shkencor për shqiptarët, e në veçanti edhe për shqiptarët e trevave lindore sepse tekstet e tij shkollore dhe universitare kanë qenë dhe janë literaturë bazë për institucionet universitare e parauniversitare të këtyre trevave. Si pedagog i lëndës Sintaksa e gjuhës shqipe që jam, mendoj dhe me plot bindje e them se Profesor Meti ka dhënë një ndihmesë të vyer e kolosale për këtë disiplinë të gramatikës së shqipes. Nga ana tjetër, askush nga gjuhëtarët shqiptarë, cilido që të jetë vokacioni a fusha themelore e kërkimit të tyre, nuk e ka quajtur dhe nuk e quan të tepërt ose të panevojshme që t’u kushtojë vëmendje edhe çështjeve që kanë të bëjnë me shqipen standarde. Prof. M. Çelikut i ka rënë barra së pari (nga Shqipëria), që të shohë nivelin e zbatimit të normës gjuhësore në Maqedoni.

Edhe pse shqiptarët pas Luftës së Dytë Botërore të ndarë nga kufij politikë, ata shpirtërisht çdoherë kanë qenë dhe sot kësaj dite janë të lidhur pas parimit “**një komb – një gjuhë letrare kombëtare**”. Këtë që e thashë më sipër, veç tjerash, po e mbështes në dy pika: 1. nga viti 1968 e këtej shqiptarët që jetonin në ish-Jugosllavi, pas vendimit të Konsultës së gjerë shkencore të Prishtinës (prill, 1968), filluan të përdorin gjuhën letrare kombëtare (sot njihet me termin shqipe standarde) dhe drejtshkrimin e saj të njësuar dhe 2. pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të mbajtur në Tiranë (1972) të gjithë shqiptarët, edhe ne të këtyre

trevave (sot Maqedonisë së Veriut) i përqaftuar vendimet që u morën në Tiranë. Përpijekjet për zbatimin e shqipes standarde prore kanë vazhduar dhe po vazhdojnë deri më sot. Arritje në këtë drejtim kemi, por si në çdo trevë shqiptare, edhe te ne vërehen shkarje nga norma, por refuzim të shqipes standarde nga qarqet intelektuale s'është vërejtur deri më sot.

Menjëherë pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), në shtator – tetor të vitit 1973 kishte ardhur në Shkup e Prishtinë për të parë se si po ecte puna e zbatimit të rregullave gjuhësore të shqipes që u vendosën në kongresin mbarëkombëtar të 1972-ës. Veç tjerash, prof. Çeliku që atëherë do të theksonte se në Maqedoni tashmë po botohet një letërsi me vlera të mëdha artistike e me një gjuhë normative. Ky punim i tij shumë më vonë do të botohet në revistën “Jehona”, nr. 7, Shkup, 1995 me titull: “Gjuha letrare kombëtare shqipe në Kosovë e Maqedoni në vitet e para të njësimin të saj (1968 - 1975)”. Përmes këtij shkrimi të botuar në revistën “Jehona” të Shkupit, Profesori do të na japë një pasqyrë rreth përdorimit të shqipes standarde, por edhe do të paraqesë problemet me të cilat ballafaqohen shqiptarët dhe shqipja në ish-Jugosllavi. Ai kishte vënë re se shqipja ballafaqohej edhe nga faktorë jashtëgjuhësorë, për të cilat, jam i bindur se i keni të njohura. Gjatë kësaj ekspedite shumë të qëlluar, Çeliku kishte lexuar mbi 6000 faqe) nga stile të ndryshme të gjuhës letrare kombëtare, kryesisht nga letërsia artistike, nga publicistika e nga vepra shkencore të botuara në periudhën 1968 - 1973. Nga veprat e letërsisë artistike kishte vjelë kryesisht ato të shkrimtarëve dhe poetëve më produktivë, por nuk i kishte lënë mënjanë edhe veprat e autorëve më pak të njohur, autorët janë kosovarë ose autorë tjerë shqiptarë nga Maqedonia.

Tirana zyrtare, për të parë zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës letrare kombëtare shqipe në vitet (1973 - 1980) e kishte angazhuar prof. Çelikun për ta parë situatën në këto treva shqiptare. Si për periudhën (1968 - 1973), ai edhe për periudhën pas Kongresit deri në vitin 1980 mori parasysh vepra të tjera nga letërsia artistike, nga stili shkencor dhe nga revistat periodike. Në të njëjtin artikull ai më tej shton: *Për shqiptarët e Jugosllavisë si dhe për të gjithë shqiptarët në përgjithësi, përdorimi i një gjuhe letrare të njësuar është një arritje shumë e madhe, si për njësimin e gjuhës letrare shqipe ashtu edhe për zhvillimin kulturor e arsimor të vendeve tona, ajo është një shprehje e re e forcimit të mëtejshëm të unitetit të kombit shqiptar.*

Në fushën e fjalëformimit ka vënë re disa fjalë me interes, disa nga të cilat janë kalke të goditura nga gjuhët sllave (serbishtja, kroatishtja e maqedonishtja) me të cilat shqiptarët e këtyre trevave kanë kontakte të vazhdueshme, si dhe disa tipa fjalëformimi mjaft produktivë. Ja disa fjalë të tilla: *kaherë, i paradokohshëm, i kahershëm, shitore (dyqan), rrezon (hëna), rrezitem (në diell), përjetoj, nënkresë (jastëk), shtrojë (dyshek), rrokaqiell (grataçelë), përparësi (prioritet), ngarend, tymtar (oxhak), drejtpeshim (ekuilibër), shikues (telespektator), shkolloj, i shkolluar, shkollim, pëshpëritës (sufler), befasohem, njoftoj (prezantoj), kërrat (gjeli), qumështore (punishte qumështi), përgojime (thashetheme), hamendem, shpirtvogëlsi, ithtar, eptim (fleksion), kalamendem, çmeritem, përoidhem, flakadanë, përpjetës, paskodër, pasbjeshkë, kështjellar, harkor, bashkëkohor, tejkallim (kapërcim i një problemi), dënes (qaj me dënesë), mbulesë (kopertinë), i ngujuar etj.*

Me të drejtë e ka konstatimin prof. M. Çeliku se me gjithë zhvillimin e madh, në shqipen standarde që përdorej dikur në ish-Jugosllavi (sot Kosovë e Maqedoni e Veriut) vihen re dy palë ndikimesh: ndikime dialektore dhe ndikime të serbokroatishtes (sot serbishtes dhe kroatishtes) e të maqedonishtes. Ndikimet e gjuhëve sllave vazhdojnë të ndikojnë mbi gjuhën shqipe, si në leksik edhe në gramatikë. Si dukuri dialektore të këtyre trevave ka veçuar: a. zanorja fundore ë shpesh nuk përdoret në shumësin e shquar të disa emrave, si: dhent, miqt, pleqt, zogjt etj.; b. Te disa folje ka vërejtur dyzanorëshin **ue** të gegërishtes letrare, si: shikuen, u hutue, dërgue. Ndërsa ruhet grupi **vo** në krye të disa fjalëve: votër, e voktë. Deri në atë kohë kur është vjelë materiali janë ruajtur mbaresat **-vet** për **-ve** në gjinore - dhanore shumë: *kafshatën e fëmijëve, ua shtonin njerëzve*; kishte vërejtur përdorimin e madh të pjesëzas **qe** në vend të **ja**: *Qe shokët!; Qe ku jam, shoku drejtor*.

Shqiptarët në ish-Jugosllavi (sot në R. e Kosovës, sidomos në Maqedoni e Kosovën Lindore) janë dygjuhësorë e disa edhe tregjuhësorë. Andaj, që në atë kohë, prof. Çeliku, ka vënë re ndikime jo të pakta të serbokroatishtes e të maqedonishtes si në fushën e leksikut ashtu edhe në ndërtimet sintaksore, si: *dëshiroj (i uroj) (i dëshiron fat në jetë vajzës) (nga "zheli mu")*; *vozis (ngas makinën) (nga "voziti")* etj.

**"Sintaksa e gjuhës shqipe" e prof. dr. Mehmet Çelikut vjen me kthesa të rëndësishme teorike dhe me terma të rinj.** Libri me titull Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik, i sintaksologut të njohur shqiptar, prof. Mehmet Çelikut, është një fryt i një përvoje bukur të gjatë, i një pune disa dhjetëvjeçare e njërit prej njohësve më të mirë të ndërtimit gramatikor të gjuhës shqipe. Ky botim i ri paraqet një trajtesë të re teorike, më se të nevojshme, për disa edhe i vonuar në fushën e sintaksës. Është e njohur se studimet në fushë të sintaksës nuk kanë munguar, megjithatë, Sintaksa e gjuhës shqipe, është një disiplinë që në hapësirat shqiptare kishte mbetur më larg zhvillimeve në krahasim me gjuhësinë botërore. Vitet e fundit kjo disiplinë po sheh një lulëzim të admirueshëm. Kisha rastin që një pjesë të vogël të librit, ta shoh ende pa e parë dritën e botimit, (në nëntor 2012) kur me profesorin u takuam në konferencën shkencore të organizuar nga Universiteti i Tiranës, më saktë në konferencën shkencore "Java e Albanologjisë" të cilën e organizonte Fakulteti i Filologjisë dhe i Historisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe. Edhe pse me prof. Çelikun u njohëm qysh në vitin 2008 në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë të USHT-së që punimet e tij, atë vit, i zhvillonte në Ohër.

Libri me titull *Sintaksë e gjuhës shqipe* dhe me nëntitull *Përbërësit sintaksorë* është një trajtesë e re teorike në fushë të sintaksës së shqipes, ku të gjitha strukturat sintaksore vështrohen në sistem, në dritën e arritjeve të gjuhësisë bashkëkohore evropiane-amerikane. Autori i librit është mbështetur në arritjet e gjertanishme, të huaja e të vendit, në fushë të sintaksës dhe të shkencave gjuhësore të afërta me të. Gjithashtu, prof. Çeliku, ka në konsideratë edhe arritjet e deritanishme të sintaksës tradicionale shqiptare dhe evropiane, perëndimore e lindore. Përpjekjet për modernizimin e sintaksës së shqipes nuk kanë munguar edhe më parë, nga gjuhëtarë shqiptarë me emër, kohëve të fundit edhe nga disa studiues të rinj, por vështrimet

përgjithësisht kanë qenë të pjesshme e jo në sistem, duke u kufizuar në tema të caktuara dhe kryesisht në paraqitjen me material nga shqipja e disa koncepteve teorike të sintaksës strukturaliste e gjenerativiste. Autori thekson se në këto përpjekje, pra në përpjekjet për zbatimin e teorisë së huaj në shqipe, ka munguar vështrimi kritik i teorisë së huaj dhe përshtatja e saj në përputhje me specifikat në gjuhën shqipe. Ekspozimi i teorive të huaja, nëpërmjet përkthimeve e përshtatjeve, duke i ilustruar me shembuj nga shqipja, është i dobishëm, por i pamjaftueshëm. Andaj, kërkohet një studim krijues e sistemor i sintaksës së shqipes në tërësi. Duke e pasur parasysh se arritjet e fundit të shkencës shqiptare e të huaj në fushë të sintaksës nuk janë marrë në konsideratë sa dhe si duhet. Lexuesit e këtij libri për herë të parë do të ndeshet me termin 'përbërës sintaksor' (shkurt 'përbërës') që do të nënkuptojë/zëvendësojë termin 'frazë', që përdoret në gjuhësinë angleze-amerikane, termat 'sintagmë' e 'grup fjalësh', që përdoren në gjuhësinë frënge, gjermane, italiane etj. Sintaksa bashkëkohore studion përbërësit sintaksorë dhe lidhjet e tyre në fjalinë e thjeshtë dhe në periudhë. Në këtë sintaksë është vënë theksi veçanërisht në analizën sintaksore të tipave ndërtimorë dhe të funksioneve gramatikore të përbërësve sintaksorë, d.m.th. përbërësit sintaksorë studiohen nga pikëpamja ndërtimore dhe funksionale. Në këtë sintaksë zëvendësohet analiza sipas teorisë së togfjalëshit të gramatikës tradicionale me teorinë e përbërësit sintaksor (sintagmës) të gjuhësisë së sotme evropiane-perëndimore. Për dallim nga Gram. e Akad. këtu njësitë sintaksore janë dy: 1. përbërësi sintaksor (barasvlerës i 'sintagmës') dhe 2. fjalia. Sipas prof. M. Çelikut fjalitë e thjeshta dhe periudhat më shumë afrojnë sesa dallojnë midis tyre: ato afrojnë kuptimisht dhe strukturalisht: ato afrojnë kuptimisht e strukturalisht në një shkallë të madhe; dallimet midis tyre janë minimale. Periudhat nuk arrijnë dot të ngrihen në nivelin e njësisë së veçantë sintaksore, ndryshon nga ai i sintaksës tradicionale, e cila e klasifikonte periudhën si njësi të veçantë sintaksore. Në librin Sint...vërehet termi fjali e përbërë në vend të termit periudhë (term që e ndeshim edhe më herët në sintaksat shqipe). Bërthamat predikative të periudhës i quan sifjali (këtë term e hasim edhe më parë te autori i njëjtë edhe atë në librin "Tekst ushtimesh për sintaksën e shqipes standarde") ose përbërës sifjali i cili zëvendëson termat tradicionale 'pjesë', 'njësi', 'fjali' për nëndarjet e periudhës, të cilët janë të papërshtatshëm (sepse termi 'pjesë' ka një kuptim shumë të gjerë, termi 'njësi' përdoret në terminologjinë gjuhësore për të emërtuar nocione të tjera, termi 'fjali' nënkupton njësitë sintaksore me intonacion të përfunduar, çka i mungon pjesës së periudhës).

Libri Sintaksë e gjuhës shqipe, vepër e fundit madhore e gjuhëtarit të shquar shqiptar M. Çelikut, e pasuron trashëgiminë gjuhësore, veçanërisht atë sintaksore, dhe tekstologjinë shkollore e shkencore shqiptare, prandaj kjo sintaksë e re e gjuhës shqipe pa dyshim që do të bëhet një libër pune për pedagogët e specialistët e rinj të shqipes, për studentët universitarë e pasuniversitarë dhe për mësuesit e gjuhës shqipe në të gjitha hapësirat ku flitet dhe mësohet shqipja si gjuhë amtare. Të shpresojmë, që konceptet e saj, por jo doemos termat, duhet të depërtojnë edhe në tekstet e gjuhës shqipe për shkollën 9-vjeçare e të mesme, në mënyrë që të mos ketë më tekste ku sintaksa të mbështetet në konceptin e togfjalëshit.

Si përfundim, ndikimet e gjuhëve sllave vazhdojnë të ndikojnë mbi gjuhën shqipe, si në leksik ashtu edhe në gramatikë. Madje ndikimet në shpirtin e gjuhës shqipe, pra në sintaksën e saj, shqipja i ka pasur çdoherë, madje për këto rreziqe gjeniu i letrave shqipe, I Kadare, do të thoshte: *Kur në sulm hodhën turqit / hordhitë e pambaruara / kështjellat e sintaksës / s'i muar që s'i muar...* andaj që kështjellat e sintaksës t'i kemi çdoherë të shpirtit të shqipes duhet që në mënyrë institucionale të mbrohet shqipja në Maqedoninë e Veriut. Të shpresojmë që me themelimin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve të përmirësohet gjendja e shqipes, sepse kaq mund të bëjnë gjuhëtarët dhe dashamirët e shqipes.